

**VENICE MINISTERIAL CONFERENCE**

**DEKLARATE  
E KONFERENCES SE MINISTRAVE  
PËR ZHVILLIMIN E QENDRUESHEM TE PESHKIMIT NE  
MESDHE**

## DEKLARATE E KONFERENCES MINISTRORE

### PËR ZHVILLIMIN E QENDRUESHEM TË PESHKIMIT NË MESDHE

#### Hyrje

1. Ne, Ministrat dhe perfaqesues të Komisionit European, pergjegjes për peshkimin, jemi takuar në Venecia, me 25 dhe 26 Nentor 2003. Takimi yne ka qene ndertuar në baze të parashtrimit të Konferences Diplomatike te Kretes, 1994 dhe Venecias, 1996 dhe takimi pergatitor për këtë Konference të Venecias, e cila i dha shprehjen e vet konkrete marreveshjeve të reja të bashkepunimit për zhvillimin e qendrueshem dhe të pergjegjshem të peshkimit në të gjithë Basenin e Mesdheut në kuader të instrumentave perkates ligjore nderkombetare.

#### Politikat Peshkore në Mesdhe.

2. Në verejme me kenaqesi se që nga Konferenca e Pare Diplomatike, janë bere progrese që japin shkas për optimizem lidhur me vendosjen e sistemeve të shumeaneshme të menaxhimit te resurseve duke lejuar shfrytëzimin e qendrueshem të resurseve peshkore në të gjithë pellgun e Mesdheut si dhe marre në konsiderate mbrojtjen e mjedisit.
3. Ky progres ka perfshire një permiresim të dukshem në keshillimin shkencor të menaxhimit të peshkimit paraqitur permes Komitetit të Keshillimit Shkencor të Komisionit të Pergjithshem të Peshkimit për Mesdheun (GFCM) dhe implementimit të Programeve Kerkimore Rajonale. Kjo ka rezultuar në adoptimin nga ana e GFCM të rekomandimeve në menaxhimin e disa stokeve të specieve fundore dhe pellagjikeve të vegjel.
4. Jemi të ndergjegjshem që ka akoma një numer sfidash për t'u arritur:
  - GFCM duhet të loze një rol aktiv si një Organizate Rajonale pergjegjese për vleresimin dhe menaxhimin e resurseve peshkore në të gjithë pellgun e Mesdheut.
  - Anetaret e GFCM duhet të ndjekin dhe intensifikojne perpjekjet për të lejuar Komisionin të realizoje mandatin e tij vecanerisht në pergatitjen kohore të të dhenave dhe informacionit sikurse pjesemarrjen aktive të shkencetareve në vete punen e Komitetit Keshillues Shkencor (SAC).
  - Vleresimet shkencore të realizuara në kuader të GFCM-se dhe Komisionit Nderkombetar për Mbrojtjen e Tonit të Atlantikut (ICCAT) duke perfshire speciet fundore dhe pellagjikeve të vegjel e të medhenj flasin për mbishfrytëzim të disa stokeve, dhe nevojën e reduktimit të zenieve te te vegjelve dhe regullimin e sforcos se peshkimit.
  - Persa i perket mbrojtjes mjedisore, duhen të ndermeren hapa për të ruajtur biodiversitetin dhe integrimin e ekosistemeve detare në vecanti nga zeniet e padeshiruara si dhe praktikat e shkarkimit të skartove.

#### Qellimi për të vepruar

5. Ne vendosim masat e meposhtme që i pershtaten kesaj Konference që të realizoje keto sfida.

6. Ftojme GFCM te mbaje nje sesion te jashtezakonshem ne gjysmen e pare te 2004, nen depozitimine ratifikimit te 16 duke duke perfshire buxhetin autonom, në menyre që të finalizohet reforma e GFCM-se, duke krijuar buxhetin dhe strukturat perfundimtare dhe identifikuar masat qe Palet deshirojne te implementojne permes GFCM.

7. Ne marrim persiper të themelojme dhe implementojme permes GFCM politikat Mesdhetare të skicuara që të garantojne nje shfrytezim te qendrueshem te stoqeve migratore dhe te perbashketa. Ne fund, rekomandojmë:

(a) Forcimin e vleresimit shkencor te stokeve në të gjithë Mesdheun dhe organizimin e mbledhjes sistematike dhe shperndarjes se te dhenave statistikore mbi zeniet tregtare dhe sforcot e peshkimit. Ftojme GFCM permes Komitetit Keshillues Shkencor te nxjerre propozime konkrete si të arrije ato objektiva dhe ti parashtroje ato GFCM-se në sesionine tij të 29, planifikuar per Tetor 2004.

(b) Të zhvilluarit e manaxhimit të resurseve dhe mekanizmat e përshtatshem te ruajtjes per natyren e vecante te peshkimit Mesdhetar, bazuar kryesisht mbi:

– rregullat mbi sforcen e peshkimit.

– ndonje mase teknike që konsiderohet e nevojshme, duke perfshire krijimin e zonave dhe/ ose periudhave ne te cilen aktivitetet e peshkimit jane te ndaluara ose kufizuara, duke perfshire mbrojtjen e zonave të shtimit dhe celjes se vezeve sikurse permiresimi i selektivitetit të peshkimit për te kufizuar impaktet negative ne biodiversitet.

Me një kendveshtrim ne zhvillimin e ketyre mekanizmave manaxhuese, e harmonizuar ne nivel Mesdhetar, ne marrim persiper organizimin e nje Mbledhje Pune. Mandati i kesaj Mbledhje Pune do te jete të skicoje propozimet konkrete qe ti prezantohen GFCM-se në fund te Sesionit të 29, planifikuar ne Tetor 2004.

(c) te vazhdoje Programet aktuale Rajonale te FAO me objektivin e zhvillimit të metejshem te tyre dhe te siguroje mbulimin te te gjithë Bazenit e Mesdheut.

8. Në menyre që luftoje peshkimin ilegal, te parregullt dhe parraportuar ne Mesdhe, ftojme GFCM-ne ne Sesionin e 29, planifikuar ne Tetor 2004 te adoptoje masat efikase bazuar në Planin Nderkombetar te FAO-s të Planit të Veprimit për Ruajtjen, determinimin dhe Eliminimin e peshkimit Ilegal, të paraportuar dhe të parregullt (IPOA-IUU). Konsiderojme që duhet ti jepet prioritet krijimit te procedurave per identifikimin e anijeve qe zhvillojne aktivitet IUU (lista e zeze), sikurse veprimet qe do te merren kunder ketyre mjeteve, dhe, per me teper, per te krijuar regjistrat e mjeteve te autorizuara per peshkim ( listat e bardha).

9. Ne e njohim që sukcesi i nje polike të qendrueshme per manaxhimin dhe ruajtjen e burimeve te peshkimit perfshin implementimin ne GFCM te nje sistemi te përshtatshëm të sistemit te duhur të inspektimit për natyren e vecante të peshkimit Mesdhetar.

Në marrim në konsiderate që sistemi i inspektimit duhet të bazohet mbi principet e mëposhtme:

- (a) Duhet të jetë në përputhje me parimet e Marrëveshjes së krijimit të GFCM- së dhe ligjin ekzistues ndërkombëtar përkatës.
- (b) Duhet të krijohet hapësirë përgjegjëse kryesore të Shtetit flamur sikurse përgjegjëse të Shtetit port dhe Shtetit bregdetar për të siguruar përputhjen me masat menaxhuese.
- (c) Duhet të marrë në konsideratë kosto-eficiencën si e masave të përgjithshme të zbatueshme në të gjithë peshkimet ashtu dhe masat specifike të aplikueshme në rast pas rasti, bazë në disa peshkime.

Mbi bazën e këtyre parimeve, ftojme GFCM të adoptojë në 2004 drejtimit kryesor të politikës mbi skemën e kontrollit me qëllim zhvillimin e masave progresive që përcaktojnë kryesisht detyrimet e Paleve, përdorimin e teknologjive dhe mekanizmave të reja për inspektimin në det dhe në port.

10. Përkundërt të kaluarës të bashkëpunimit të ngushtë ndërmjet të gjithë Shteteve duke përfutur nga kushtet biologjike të mjedisit detar Mesdhetar, konsiderojmë që krijimi i zonave të mbrojtura të peshkimit lejon përmirësimin e mbrojtjes dhe kontrollit të peshkimit dhe ato kontribute të manaxhimit me të mirë të burimeve dhe të angazhimit të përbashkët për të luftuar peshkimin e paligjshëm.

Në konsiderojmë që, pa asnjë paragjykim mbi të drejtën sovranë të Shteteve si dhe në përputhje me ligjin ndërkombëtar përkatës, një ekzaminim më i detajuar duhet të bëhet për modalitetet e krijimit të zonave të mbrojtura të peshkimit duke marrë parasysh precedentet që ekzistojnë, nga pikepamja e punësimit në këndvështrimin rajonal të përshtatshëm me nevojat e peshkimit në fjalë dhe bazuar mbi dialogun dhe koordinimin.

Me qëllim që të shkohet me përpara në këtë drejtim, Shtetet Mesdhetare do të bashkëpunojnë në nivelet të përshtatshme rajonale.

11. Në shpirtin e solidaritetit në Mesdhe dhe duke marrë parasysh rëndësinë e masave të nevojshme të manaxhimit të implementuar, masat kontrolluese dhe ruajtëse, rëndësi duhet të jepet nevojave të vecanta të zhvillimit të shteteve bregdetare në përcaktimin dhe implementimin e masave të tilla.

Me këtë qëllim shteteve në fjalë duhet t'u jepet asistencë financiare dhe mbështetje tekniko shkencore për të kontribuar në zhvillimin e tyre.

12. Ftojme GFCM të bëjë një vlerësim vjetor të masave të implementuara në përgjigje të kësaj deklarate.

-Peshkimi i paligjshëm, i pargullt dhe i parrapotuar, i cili çorienton efektivitetin e mbrojtjes në masat menaxhuese duhet të luftohet.

Venecia, më 26 Nëntor 2003

Emrat dhe firmat e Ministrave